# Udhëzim për **grumbullimin e diferencuar të mbeturinave**

Gjoba prej 167 euro për ata që braktisin mbeturinat në rrugë ose nuk kryejnë grumbullimin e diferencuar të mbeturinave.

## LETRA KARTON DHE TETRAPAK



**po** Gazeta, fletore, libra, zarfe, shirita, fotokopje, fleta, fletushka dhe libërtha prej letre; qese prej letre; kuti Tetrapak për pije dhe ushqime (lëng frutash, qumësht, verë, salcë dhe bishtajore): kutiza, kuti të mesme dhe kuti të mëdha kartoni; karton i valëzuar; karton për pica.

**Kujdes: letra e ndotur me ushqim ose me materiale të tjera nuk duhet përzierë me letrat.**

**NDALOHET PËRDORIMI I QESKAVE PLASTIKE PËR GRUMBULLIMIN E LETRËS DHE KARTONIT**

**jo** Letër e plastifikuar, kimike dhe e vajosur; letra dhe kartonë të ndotur me ushqim ose me substanca të tjera.

## XHAM PLASTIKË KANAÇE DHE METALE



**po** Shishe, vazo, enë mbajtëse prej xhami, plastikë, alumin dhe metal; kova dhe magje; tubo dhe tubete bosh; kanaçe; celofan, letër alumin dhe shirit mbështjellës i tejdukshëm; thasë, qeska, qese, qeska për pazar dhe rrjeta plastike; kuti dhe qeska për biskota, ëmbëlsira dhe patatina; pjata dhe gota plastike për një përdorim të vetëm pa mbetje ushqimore; bombola spray bosh; kapakë, kafaze dhe tapa.

**Kujdes: materialet nuk duhet të përmbajnë mbetje ushqimi ose produkti.**

**jo** Porcelan, qeramikë dhe Pirex, gota xhami; kristali; pasqyra, lastra xhami, llamba dhe tubo neoni; lugë e pirunë plastike për një përdorim të vetëm; lodra dhe sende prej gome.

## MBETJE ORGANIKE



**po** Mbetje nga kuzhina, teprica ushqimi, fruta dhe perime, bukë e vjetër, lëvozhga veze; mbetje kafeje dhe filtra çaji; ushqime të prishura dhe të skaduara; lule të prera dhe bimë shtëpiake; peceta letre; kartonë për pica tepër të ndotur me ushqim (të prerë në copa); shtroja për kafshë të vogla shtëpiake.

**KUJDES: mbyllini mirë qeskat për të shmangur erën e keqe**

**jo** Pelena dhe peceta thithëse higjienike (Lines); ambalazhe dhe kuti.

## MBETURINA TË THATA



**po** Lecka të ndotura; gomë; letra të vajosura, të plastifikuara dhe kimike; lugë e pirunë plastikë, gota xhami dhe kristali; pelena dhe peceta thithëse higjienike (Lines); shiringa dhe gjilpëra me kapuç; qese për fshesat me korrent; sende të vogla prej druri; lodra të thyera pa përbërës elektrikë ose elektronikë; qeramikë, porcelan dhe deltinë e pjekur (baltë); kolora, gërshërë dhe stilolapsa; kaseta audio dhe video, floppy disk, cd.

**jo** Mbetje të rënda dhe inerte; letër, karton dhe Tetrapak; xham, plastikë dhe kanaçe; mbetje organike.